



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe nenit 13 paragrafi 1.2 të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, ndërlidhur me nenet 11, 12.2 shkronja d), 51.1 dhe 52.1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.4, nenit 47 paragrafi 1, dhe 48 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, referuar kërkesës nr.020-2/8 të datës 30.05.2025 së MAPL-së për rishqyrtimin e vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-016/01-0022129/25 të datës 18 prill 2025, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2025, mori këtë,

V E N D I M

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa-KPF sipas Vendimit nr.prot.01-020/04-0111883/21 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa datë 30 dhjetor 2021 i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin nr.prot.01-020/04-0093828/21 datë 07 nëntor 2022, dhe Vendimin nr.prot.01-016/01-0078834/24 datë 11 dhjetor 2024, dhe atë:

- **znj.Lirika Maliqi**, emërohet anëtare e Komitetit për Politikë dhe Financa, në vend të znj.Drita Pajaziti e cila ka dhënë dorëheqje nga funksioni anëtare e Kuvendit të Komunës.

Neni 2

Ky Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit bazë nr.prot.01-020/04-0111883/21 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, të datës 30 dhjetor 2021.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021, si dhe Ligjit Nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.Prot.01-016/01-0036075/25
Podujevë, datë, 26 qershor 2025

